



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e **gjashtë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **04.09.2023** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti i punës së kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmuorin e parë të vitit 2023;
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit;
4. Propozimvendimi për miratimin e raportit, nr. 14-050/01-85379/23, dt. 28.4.2023, të komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale;
5. Propozimvendimi për miratimin e raportit, nr. 14-020/04-0171429/23, dt. 15.4.2023, të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali;
6. Propozimvendimi për miratimin e raportit, nr. 14-050/01-85384/23, dt. 28.4.2023, të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në Zonën Industriale;
7. Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit, nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit;

9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Alping", SHPK;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Delta Invest", SHPK;
11. Projektregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, dt. 16.6.2010;
12. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", për bllokun "A-11" në Prishtinë;
13. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re-Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual – njësitë hapësinore "I, L, G" në Prishtinë;
14. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërnice e Epërme, në Prishtinë;
15. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival – Prifest;
16. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për shoqatën për kultivimin e artit skenik "Sythi";
17. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Gran Fest – Kosova;
18. Pyetje dhe përgjigje;
19. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-174917/23, më 23.8.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci

